



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2025:000498

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06909250

P.nr.04/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA VITI, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues, Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Ema Ajvazi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.A., nga fshati T.. – Komuna e V., për shkak të veprave penale Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër P.II.nr.0../2025, të datës 13.01.2025, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jo publik të datës 29.01.2025, në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri, mbrojtësi i viktimave nga ZMNV në Gjilan Egzon Maloku, i dëmtuari B.A., dhe i pandehuri A.A., me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatin Idriz Syla, mori dhe shpalli më datë 29.01.2025, ndërsa më datë 18.02.2025 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.A., nga babai B., nëna Q., e gjinisë H., i lindur më datë 12.06.1996, në fshatin T.– Komuna e V., ku dhe jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

Ë S H T Ë F A J T O R

I

I pandehuri: A.A.,

Sepse, më datë 01.01.2025, rreth orës 19.00, në fshatin T., Komuna e V., në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri A.A., me dashje dhe me qëllim të ushtrimit të pushtetit dhe kontrollit, cënimit të dinjitetit tek babai i tij, tani i dëmtuari B.A., ka shkaktuar dhunë në familje, përmes dhunës psikologjike në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe 1.8 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, ashtu që gjersa i dëmtuari ishte në shtëpi së bashku me vajzën e tij V.A., – tani dëshmitare, i pandehuri hyn brenda në shtëpi dhe kërkon para nga i dëmtuari, e ku pasi i dëmtuari thot se nuk kam para, i pandehuri shkon në dhomën e të pandehurit të cilën e hap me forcë duke e thyer dhe nga aty merr para në vlerë prej 6750 Euro, dhe e kanos të pandehurin me fjalët se “edhe 100 mijë euro të tjera mi jep, përndryshe nëse nuk mi gjen ke me pas punë me mua”, me ç’rast i pandehuri

me veprimet e tij pos që ka cënuar rëndë dinjitetin e të dëmtuarit, ka shkaktuar dhembje, frikë dhe shqetësim të madh emocional.

-me çka ka kryer veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

II.

Nga koha e pacaktuar e deri më datë 02.01.2025, rreth orës 13:45 min, në fshatin T.. – Komuna e V., gjegjësisht në shtëpinë e të pandehurit, i pandehuri A.A., me dashje dhe në kundërshtim me Ligjin për armët nr.05/L-022 ka mbajtur nën kontroll dhe posedim në mënyrë të paautorizuar armë, ashtu që pas kontrollit, zyrtarët policor tek shtëpia e të pandehurit kanë gjetur një pistoletë Ekol Special me numër serik 1235555 dhe një karikator, ku në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij dhe në kundërshtim me Ligjin për Armët ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të pa autorizuar armë të cilat edhe janë sekuestruar.

-me çka ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 46, 48, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit, 322, 364 dhe 451 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), të pandehurit i:

GJYKON

Të pandehurin A.A., për veprën penale nga pika I, të këtij aktgjykimi e dënon me gjobë në shumë prej 500 Euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 120 ditësh, për pikën II të këtij dispozitivi e dënon më gjobë në shumë prej 500 Euro.

Me pëlqimin e të pandehurit, dënimi i shqiptuar me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 500 Euro, ashtu që dënimin me gjobë në shumë prej 1500 Euro, i pandehuri detyrohet ta paguaj, në afat prej 15 (pesë) ditësh, pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari, nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzet) euro të dënimit me gjobë.

Të pandehurit, koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 02.01.2025 deri më datë 29.01.2025, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit sot më datë 29.01.2025, për të cilën gjykata do të nxjerrë aktvendim të veçantë.

Detyrohet i pandehuri të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) € dhe 20 (njëzet) € për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 i KPRK-së të pandehurit i konfiskohet arma pistoletë Ekol Special me numër serik 1235555 dhe një karikator.

I dëmtuari nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Më datë 04.01.2025, në Gjykatën Themelore Gjilan – Dega në Viti, të pandehurit A.A., sipas kërkesës për caktimin e paraburgimit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 muaji dhe atë nga data 04.01.2025 deri më datë 31.01.2025, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 13.01.2025, në Gjykatën Themelore Gjilan- Dega Viti, e ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.0../2025, të datës 13.01.2025, ndaj të pandehurit A.A., nga fsh.T., Komuna e V., për shkak të veprës penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 29.01.2025, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe jopublik, në të cilën kanë qenë prezent prokurorja e shtetit Iliriana Haziri - Kryeziu, i dëmtuari B.A., mbrojtësi i viktimave Egzon Maloku dhe i pandehuri A.A., me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Av. Idriz Syla Në këtë seancë i pandehuri, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilat akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas përkrahimit në aktakuzë.

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 322 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2 të KPPRK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit të lartcekur për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza edhe atë: raporti i incidentit me numër të rastit 2024 – CG0456, i datës 29.12.2024, deklarata e të dëmtuarit I.R., i datës 29.12.2024, 3 foto pa ngjyre, deklaratat e dëshmitarve B.R., A.R., në Stacionin e Policisë në Viti më datë 29.12.2024, deklarata e të pandehurit E.R., më datë 29.12.2024, ekspertizën psikologjike të punuar nga eksperti Dr. Sh.J., – psikolog Klinik, e datës 03.01.2025, ekspertiza mjekoligjore, e punuar nga eksperti Dr. N.U., e datës 09.01.2025, si dhe shkresat e tjera në lëndë dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 29.01.2025, dëgjimit të palëve, konform nenit 190 paragrafi 1 të KPPRK-së, të pandehurit A.A., ia ka ndërprerë masën e paraburgimit me aktvendim të veçantë P.nr. 1/2025 të datës 04.01.2025, ngase erdhi në përfundim se kanë pushuar të gjitha kushtet ligjore për të cilat i'u kishte caktuar masa e paraburgimit.

2.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri A.A., ka kryer veprat penale, Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 dhe 3.2 lidhur me

paragrafin 1 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

3.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 322 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2 të KPPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë si në dispozitiv, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se e ka pranuar fajësinë për veprat penale e cila i vihen në barrë, se është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale dhe se i ka kërkuar falje të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, vrazhdësinë e përodrur me rastin e kryerjes së veprës penale, pasojat e shkaktuara nga vepra penale. Andaj, nga të larcekurat, gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të larcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

4.Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Gjykata duke u bazuar në nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së në të cilin parashihet se “Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë”, andaj në rastin konkret i pandehurit i larcekur, ka qëndruar nën masën e paraburgimit edhe atë nga data 04.01.2025 deri më datë 29.01.2025, andaj gjykata ia llogaritë në dënimin e shqiptuar, ashtu që në rast të revokimit të dënimit me kusht çdo 20,00 (njëzet) euro të dënimit me gjobë do të barazohen me një ditë të qëndrimit në arrestit shtëpiak.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

6.Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata duke u bazuar në nenin 269 paragrafi 3 të KPRK, të akuzuarit ia konfiskoi armën-pistoletë Ekol Special m eumër serik 1235555 dhe një karikator.

7. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike

Gjykata duke u bazuar në nenin 460 paragrafi 1 të KPPRK-së, nuk e ka udhëzuar të dëmtuarin në kontest civil, pasi nuk ka paraqitur kërkesë.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin t'a obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) € dhe 20 (njëzet) €, për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditëve, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj, nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 364 paragrafi 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA VITI
P.nr.04/2025, më datë 18.02.2025

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Arben Xheladini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.